

Përgatitja e buletinit dygjuhësh: kontribut në kulturën ndërkufitare.

Procesi i integritimit evropian , si një proces në shtrirje të gjithanshme, në çdo segment të jetës shqiptare , vitet e fundit po sheh zbatim edhe në drejtim të bashkëpunimit institucional të bibliotekave publike shqiptare me ato italiane, ku , kjo gjë po arrihet falë programit "Promovimi dhe zhvillimi i modeleve inovative të bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave dhe qendrave të dokumentimit italo-shqiptar".

Në konferencën e mbajtur në Bari më 11-12 tetor të vitit 2001 , në kuadër të programit "INTERREG II Itali-Shqipëri", u vu në dukje gjendja e vështirë e bibliotekave publike në Shqipëri. Si rruga më e sigurtë dhe më efektive për rritjen e bashkëpunimit dhe përmirësimin në drejtim të bibliotekave, u mendua përfshirja e drejtpërdrejtë e disa bibliotekave publike dhe qendrave shqiptare të dokumentacionit (mes tyre dhe biblioteka e qytetit të Shkodrës "Marin Barleti") në struktura-pilot , përmes të cilave pasqyrohen risitë dhe bëjnë të konsolidohen në territorin shqiptar modele që nxisin zhvillim në këtë fushë.

Sipas kriterëve të projektit, stafi i Shkodrës , ashtu si dhe ai i bibliotekës së Tiranës dhe Elbasanit , përbëhet nga 6 të rinjë , - kjo për faktin , se janë pikërisht të rinjtë që përbëjnë një nga burimet më të rëndësishme për zhvillimin social e ekonomik dhe për bashkëpunimin midis dy vendeve; e në të njëjtën kohë, për t'i korresponduar një prej treguesve të BE-së.

Dhe pikërisht , sot, pas arfo një vit bashkëpunimi me Bibliotekën e Shkodrës, ku, deri diku mund të flitet tashmë për integrim edhe të bibliotekës publike "Marin Barleti" në rrjedhën e atyre evropiane, mund të pohoj me kënaqësi rezultatin e kënaqshëm të punës së stafit të të rinjve të Shkodrës në lidhje me përgatitjen e tre numrave të parë të buletinit bibliografik e tematik dygjuhësh.

Duke iu referuar objektivit bazë të punës sonë: "Promovimi i trashëgimisë biblio-dokumentare të bibliotekës publike të qytetit të Shkodrës, e veçanërisht asaj të përcaktuar si vlerë kulturore", stafi ynë po bën një punë efikase , me shumë dëshirë e mjaft të kujdesshme në përmbushjen e saktë të kësaj detyre. Në të njëjtën kohë, konstatohet edhe një rritje e profesionalitetit të këtij stafi, në fushën e informacionit dhe të dokumentimit, predispozicionit për kushte favorizuese për nxitjen e integritimit në anën tejkuftare dhe konsolidimin e kushteve që karakterizojnë zhvillimin në shoqëri të informacionit e njohurive .

Mund të pranojmë, që në fillim të punës sonë në Bibliotekë , hasëm vështirësitë normale të një eksperience të re, por që shumë shpejt, falë ndihmës profesionale të punonjëseve të kualifikuara të kësaj biblioteke, arritëm të orientohemi me punën kërkimore të materialeve në fondet përkatëse, për

evidentimin e saktë informativ e bibliografik në buletin, në bazë të temave të paracaktuara .

Në lidhje me tematikën e çdo numri buletini, stafi ynë organizon takime të herëpashershme me drejtorin e bibliotekës, ku pas hedhje ideshë e diskutimesh , bëhet përcaktimi i temave përkatëse. Përzgjedhja e tematikës bëhet konform kërkesave e fushave të përgjithshme të parashikuara në Programin INTERREG III , si nga: letërsia, gjuhësia, sociologjia, ekonomia, traditat etj, apo edhe siç është rasti i buletinit të fundit monotematik , mbi bibliotekat e Shkodrës, me këto tema:

- Tradita e bibliotekave në Shkodër.
- Biblioteka e Tabakëve.
- Bibliotekat e enteve fetare deri në vitin 1944.
- Bibliotekat e shoqërive deri në vitin 1944.
- Biblioteka "Marin Barleti".
- Biblioteka e Universitetit dhe Muzeut të Shkodrës.
- Bibliotekat e sotme.
- Problemet aktuale mbi bibliotekat.

Si zbatuese e këtij projekti, në emër edhe të kolegeve të mia , e vlerësojmë mjaft të rëndësishëm zbatimin e tij :

- nga njëra anë, në lidhje me promovimin e njohjes së pasurive biblio-dokumentare të bibliotekës së qytetit tonë, "Marin Barleti", në kuptimin e pasurisë kulturore, për t'u vlerësuar në një prizëm ndërkulturor mbështetur nga dygjuhësimi;

- si dhe, nga ana tjetër, për faktin se tashmë frekuentuesit e bibliotekës së Shkodrës - pjesëmarrëse në këtë projekt - kanë një mundësi më tepër të shfrytëzojnë me sukses informacionin bibliografik-tematik të buletinit dygjuhësh, gjë që po çon në lehtësimin e përdorimit të një pjese të fondeve biblio-dokumentare të mbledhura.

Efektet pozitive të deritanishme në zbatimin e projektit kanë ardhur edhe si rezultat i një bashkëpunimi shumë të mirë, me konsulencë të vazhdueshme, nga përfaqësuesit e bibliotekës Multimediale të Këshillit Rajonal të Puglias - të cilët i falënderojmë. Janë vërtetë për t'u përshëndetur konceptet e bashkëpunimit dhe të partenariatit ndërkombëtar që në fillimet e këtij projekti.

Çuarja më tej e këtij bashkëpunimi ndërmjet institucioneve bibliotekore e qendrave të dokumentimit me qëllim zhvillimin dhe përhapjen e novacioneve në modelet e organizimit, drejtimit e monitorimit të pasurisë

kulturore, do të merrte akoma më tepër vlera e konsolidim në kushtet e një kohëzgjatjeje më të madhe se ajo e parashikuar në projekt. Kjo do konsiderohej një ndihmë me të vërtetë e madhe për qytetin e Shkodrës, duke qenë se edhe historia dhe kultura e tij, është e pandarë nga historia e librit dhe prania e bibliotekave në këtë qytet . Kujtojmë këtu, që, edhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë pati si bërthamë të saj kur u themelua , bibliotekën e "Komisës Letrare Shqipe" të krijuar në Shkodër në vitin 1916 .

Mbështetur në traditat e saj kulturore dhe të shkrimtarëve të saj , Shkodra është quajtur vatra e kulturës dhe e librit.